



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:251601
Datë: 04.10.2024
Numri i dokumentit: 06253665

K.DH.SH.II.nr.198/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, Instituti B, Kati Përdhese, rrethi i QKUK-së, kundër debitorit "I.S." B.I, me nr. të biznesit 810160713, me pronare I.S., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Safet Voca nga Mitrovica, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.861/23 të datës 16.11.2023, me datën 02.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit "I.S." B.I, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.861/23 të datës 16.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.861/23 të datës 16.11.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit "I.S." B.I, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 76/2023 i datës 11.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati Farmaceutik, në bazë të dokumentit përmbartues – Vendimit Nr. 10/F-032-21 i datës 27.08.2021 ka caktuar zbatimin e përmbartimit përmes urdhrin përmbartimor P.nr. 76/2023 të datës 11.05.2023 ndaj debitorit “I.S.” B.I, të cilin e ka detyruar që në emër të masës ndëshkimore të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 1,000.00 EUR, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se e kundërshton urdhrin përmbartimor me arsyetimin se urdhri përmbartimor edhe jo ligjor dhe i parregullt, sepse dokumenti përmbartimor në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor nuk e ka cilësinë e titullit përmbartimor dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Ka shtuar se debitorit është dashur që t’i dorëzohet dokumenti përmbartimor së bashku me propozimin për përmbartim në origjinal apo kopje të vërtetuar, e jo në kopje të thjeshtë. Më tej, ka deklaruar se përmbartuesi privat me rastin e lejimit të urdhrin përmbartimor nuk i ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe nuk i ka vlerësuar drejtë provat, sepse në dokumentin përmbartimor nuk përcaktohet me saktësi detyrimi i debitorit sipas objektit, llojit, vëllimit dhe kohës së përmbartjes, pra duke mos u plotësuar kushtet që duhet t’i përmbartë propozimi për përmbartim ashtu siç përcaktohet me nenin 38, par. 1 dhe 2 të LPP-së, si dhe nuk përmban të dhënat sa i përket identitetit të debitorit, pastaj se kush është personi fizik që e përfaqëson kreditorin. Ka shtuar se lidhur me të njëjtën çështje ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë për anulimin e vendimit Nr. 10/K të datës 14.10.2021 si dhe si rezultat i shkeljes së dispozitave të LPP-së ka ardhur deri tek vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike. Nga arsyet e lartcekura, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, kurse urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.861/23 të datës 16.11.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “I.S.” B.I, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 76/2023 i datës 11.05.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj, mbetet në fuqi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në rastin konkret Vendimin Nr. 10/F-032-21 të datës 27.08.2021, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi Nr. 10/F-032-21 të datës 27.08.2021 është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi Nr. 10/F-032-21 të datës 27.08.2021, është dokument i përmbarueshëm dhe i cili vendim përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të datës 07.03.2023, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim.

Gjykata mori parasysh pretendimet ankimore të debitorit, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase Vendimi Nr. 10/F-032-21 të datës 27.08.2021, përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të datës 07.03.2023, andaj i plotëson kushtet për caktimin e përmbarimit në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.198/24, me datë 02.10.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**

Numri i lëndës: 2023:251601
Datë: 04.10.2024
Numri i dokumentit: 06253665